

Gjyqësor Durrës për kryerjen e hetimeve objektive e të gjithanshme, kjo dhe për faktin se procedimi penal është përcjellë disa herë në prokurorë të ndryshëm të atij organi.

Mbi shqetësimin e shtetasit V. V., më datë 23.08.2017, me shkresën nr.K2/V14-3 i kemi kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila më datë 05.09.2017, me shkresën nr. 4125/1 (bashkëlidhur kopje e shkresës), informon ndërmjet të tjerave Institucionin e Avokatit të Popullit se:

Mbi bazën e kallzimit penal të shtetasit V. V., datë 02.06.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rregjistruar procedimin penal nr.875/2010, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme, më datë 28.04.2011, është vendosur pushimi i hetimeve bazuar në nenin 328 pika 1 gërma “d”, me arsyetimin se: *“për të gjitha faktet e kallëzuar nga shtetasi V. V., është parashkruar vepra penale. Plotësimi i afateve të parashkrimit të ndjekjes penale përbën shkak për të cilin vepra penale shuhet dhe hetimet paraprake lidhur me to nuk duhet të vazhdojnë. Nisur nga kjo, konkludohet se, natyra e konflikteve të parashtruar nga kallëzuesi, ka natyrë juridiko-civile dhe administrative, për pasojë ato mund të zgjidhen në rrugë administrative dhe gjyqësore civile”*.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kallëzuesi V. V., në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, e cila me vendimin nr.183 datë 16.12.2011, ka vendosur “Prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke urdhëruar për vijimin e hetimeve. Gjykata ka çmuar se: *“dokumentet e falsifikuara mund të përdoren nga të kallëzuarit N. S., e G. P., duke i paraqitur ato para Gjykatës së Apelit Durrës apo organe të tjera administrative si dokumenta të rregullta, duke i shkaktuar paqartësi gjykatës dhe duke kërkuar përfitime të mbështetura mbi dokumente të falsifikuara. Për këtë organ i Prokurorisë nuk ka kryer hetime, nuk janë kryer akte ekspertimi për të provuar e përcaktuar cilat janë dokumenta të falsifikuara dhe se ku qëndron falsifikimi i këtyre dokumenteve. Gjithashtu organi i Prokurorisë duhet të hetojë nëse këto dokumenta të falsifikuara, përdoren aktualisht dhe nga cilët persona”*.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, sipas vendimit nr.101/10-2013-1998 datë 12.12.2013, në të cilën i le detyrë prokurorisë: *“të kryejë veprime hetimore lidhur me faktin penal të përdorimit të dokumenteve zyrtare, tashmë të konformuara si të falsifikuara, si dhe individualizimin dhe përcaktimin e qartë të pozicionit të punonjësve të Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe nëse dokumentacioni i konfirmuar i falsifikuar është përdorur gjatë kësaj kohe apo në vazhdimësi në aplikimet e personave të interesuar”*.

Pas rifillimit të hetimeve dhe kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara, Prokuroria më datë 18.05.2015, ka vendosur përsëri pushimin e hetimeve.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasi V. V., dhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr.19/281 datë 08.04.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe detyrimin e Prokurorisë që të vazhdojë hetimet në lidhje me procedimin penal nr.875/2010.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e datës 01.02.2017, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr.19/281 datë 08.04.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Kështu, Gjykata e Apelit Durrës në vendimin e sipërcituar ka lënë detyrë: *“që të kryhen veprime hetimore lidhur me faktin penal të përdorimit të dokumenteve zyrtare, tashmë të konfirmuara si të falsifikuara; kush janë dokumentet e falsifikuara, kur janë përdorur, nëse janë në vazhdimësi duke u përdorur; kryerjen e nje hetimi të plotë me ekspertë kriminalitet për të vërtetuar falsifikimet për dy akt shitblerjet datë 25.07/1997, nga Enti i Banesave Durrës tek familja B., dhe të datës 30.07.1997, nga familja B., tek G. P., dhe firmat e personave ushtarakë tek dokumentat e dhënies së pronës datë 22.07.1997 dhe 28.04.1997; nuk është hetuar për dokumentet e falsifikuara tek Enti i Banesave Durrës; nuk është hetuar në ish Komunën Rushbull, përse janë lëshuar dokumentet e falsifikuara për familjen B., etj”*.

E ndodhur para këtij fakti Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka rifilluar përsëri hetimet në lidhje me këtë procedim penal, duke kryer veprime hetimore të orientuara nga vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës. Nga verifikimi në Zyrën e Rregjistrimit Penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës rezultoi se, hetimet e procedimit penal janë rifilluar më datë 09.03.2017.

Më datë 02.02.2018, me shkresën nr.K2/V14-8, i kemi kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës informacion shtesë, për të sqaruar veprimet hetimore të kryera, arsyet e zvarritjes së hetimit të procedimit penal dhe prokurorët që ishin caktuar me hetimin e çështjes.

Më datë 12.02.2018, me shkresën nr.86/k (bashkëlidhur kopje e shkresës) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës informon Institucionin e Avokatit të Popullit se *“procedimi penal është i rregjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, pa emër personi konkret të cilit i atribuohet vepra penale. Duke qënë se ky hetim është mjaft kompleks për shkak kjo dhe të detyrave të lëna dhe se dokumentet objekt hetimi i përkasin viteve 1994, 1996, prokuroria po vijon në mënyrë dinamike kryerjen e veprimeve hetimore sipas detyrave të lëna nga vendimet e gjykatës. Prokurori që po ndjek hetimin e këtioj procedimi është z.N. T., ”*.

Duke studjuar dhe analizuar kërkesën e z.V. V., si dhe të dhënat e pasqyruara në informacionet e marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatojmë se ka zvarritje të pajustificuara prej rreth 1 viti, në ndjekjen dhe kryerjen e veprimeve hetimore të procedimit penal nr.875/2010, çka përbën cënim të një procesi të rregullt ligjor. Këto veprime vijnë ndesh me nenin 42 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirisë dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*.

E drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet në nenin 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qënë një e drejtë kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, si në respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit e gjykimit brenda një *“afati të arsyeshëm”*, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare prej tij. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Sa sipër gjejmë të drejtë ankesën e shtetasit V. V., dhe për këtë do të sugjerim vlerësimin e shqetësimit të tij, dhe me qëllim për të vënë në vënd të drejtën e shkelur, shpejtimin e kryerjes së veprimeve hetimore dhe përfundimin sa më parë të hetimit të procedimit penal, duke respektuar dhe kërkesat e parashikuara në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale.

Në funksion me gjëndjen aktuale të akteve të ndodhura në fashikullin e hetimit të procedimit penal nr.875/2010, apo veprimeve të kryera nga organi proçedues, do të kërkonim çmuarjen nga ana e juaj për transferimin e çështjes në Prokurorinë e një Rrethi Gjyqësor më të afërt, veprim i cili do të rriste dhe besimin e qytetarit ndaj organit proçedues.

Në përfundim do të sugjerimin gjithashtu që rasti i mësipërm duhet të bëhet objekt i analizës së punës së Prokurorisë duke vënë theksin në hetimet e shpejta, njoftimin sa më parë të palëve në procesin penal për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve, ecurinë e hetimit dhe veprimet hetimore të kyera, deri në marrjen e vendimit përfundimtar të hetimit, kryerjen e detyrave të lëna nga gjykatat, si dhe rritjen e aftësive profesionale të prokurorëve.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”*, si dhe nenin 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, me ndryshimet përkatëse, ku thuhet: *“Avokati i Popullit.....paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës të shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut”*.

REKOMANDOHET

“Marrja e masave me qëllim hetimin e shpejtë të procedimit penal nr.875/2010, hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe mundësinë e transferimit të çështjes në një Prokurori të Rrethit Gjyqësor më të afërt, për kryerjen e hetimeve objektive dhe të gjithanshme.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na veni në dijeni brënda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

K O M I S I O N E R I

Konc.&Dakt.P.A.
Tiranë më 22.02.2018

Arben SHKËMBI

